

Në bazë të nenit 19 paragrafit (6) të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74,25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

## RREGULLORE

### PËR NORMATIVIN E ASISTENTIT ARSIMOR, PËRSHKRIMIN E KOMPETENCAVE DHE DETYRAVE TË PUNËS

#### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen normativi për asistentin arsimor, përshkrimin e kompetencave dhe detyrave të punës.

#### Neni 2

Asistenca arsimore ofrohet për nxënësit të cilët kanë rekomandim nga Sistemi për vlerësimin e personave me vështirësi.

#### Neni 3

Asistenca arsimore realizohet nga asistenti arsimor i cili ka fituar titullin: edukator special dhe rehabilitues, pedagog, psikolog, punonjës social, pedagog social dhe rehabilitimi, sociolog, terapist familjar, mësimdhënës i grupit klasor, gjegjësisht person i cili i plotëson kushtet për mësimdhënës në grupin klasor dhe mësimdhënës i mësimit lëndor me arsim të përfunduar dhe të fituar të paktën 240 kredite sipas SETK (niveli VIA) ose të përfunduar të paktën arsimin e lartë me kohëzgjatje prej katër vitesh (të paktën shkalla VII/1).

Nëse në shpallje publike për punësim e cila është me njohuri të fituara nga paragrafi 1 i këtij neni, asistent arsimor mund të jetë edhe personi i cili ka fituar të paktën 240 kredite sipas SETK (niveli VIA) ose të përfunduar të paktën arsimin e lartë me kohëzgjatje prej katër vitesh (të paktën shkalla VII/1).

Personat e përzgjedhur për asistentë arsimorë ndjekin trajnim të detyrueshëm për asistentë arsimorë, në përputhje me Programin e Trajnimit për asistentë arsimorë, të përcaktuar nga ministri me propozim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, të realizuara nga shkollë fillore me qendër burimore.

#### Neni 4

Orari i punës së asistentit arsimor është 40 orë në javë.

Asistent arsimor nuk mund të jetë prind/kujdestar ose anëtar tjetër i familjes së ngushtë të nxënësit të cilit i ofrohet mbështetje.

Asistenti arsimor nuk mund të jetë personi kundër të cilit udhëhiqet procedurë penale ose është dënuar me vepër penale

### **Neni 5**

Asistenti arsimor programin e punës e përgatit në bashkëpunim me bashkëpunëtor profesional - edukator special dhe rehabilitues të përcaktuar nga shkolla fillore me qendër burimore.

Programi i punës i asistentit arsimor përfshin: aktivitete në procesin edukativo - arsimor dhe aktivitete për pavarësinë e nxënësve dhe realizimin maksimal të potencialit të tyre, si në pjesën arsimore ashtu edhe në pjesën e zhvillimit të aftësive sociale dhe emocionale.

Asistenti arsimor nuk është bartës i procesit mësimor, në mënyrë të pavarur nuk përgatit plan individual arsimor (në tekstin e mëtejshëm: PEI) ose program dhe burime të modifikuara për punë me nxënësin, dhe në mënyrë të pavarur nuk jep informata në lidhje me përparimin e nxënësve për persona të cilët nuk janë të punësuar në shkollë ose për persona të punësuar në shkollë të cilë nuk janë të lidhur me procesin edukativo - arsimor të nxënësit. Asistenti arsimor është anëtar i ekipit gjithëpërfshirës për nxënësin me vështirësi dhe merr pjesë në përgatitjen e PEI-t dhe programit të modifikuar.

### **Neni 6**

Asistentët arsimorë i ofrojnë mbështetje nxënësit me vështirësi në aktivitetet e përditshme mësimore dhe jomësimore, gjegjësisht, dalje, ekskursionet, edukim në natyrë në përputhje me programin vjetor të punës së shkollës.

Për aktivitetet jashtëmësimore, gjegjësisht, dalje, ekskursionet dhe edukim në natyrë, ekipi gjithëpërfshirës i shkollës ofron mbështetjen e nevojshme me qëllim për të shmangur diskriminimin, por duke marrë parasysh nevojat individuale dhe sigurinë e nxënësit.

Asistentët arsimorë ofrojnë mbështetje në kryerjen e detyrave që kërkojnë komunikim, ndërveprim shoqëror, aktivitet shqisor dhe motorik, në lëvizje, gjatë marrjes së ushqimit dhe pijeve, gjatë përvetësimit dhe kryerjes e nevojave higjienike të nxënësit dhe detyrave të tjera të punës në përputhje me nevojat individuale të nxënësit.

Në kushte të rrethanave të jashtëzakonshme në përputhje me Ligjin për Arsimin Fillor, asistentët arsimorë ofrojnë mbështetje përmes mësimin në distancë.

### **Neni 7**

Në një paralele mund të ketë vetëm një asistent arsimor.

Asistentët arsimorë ofrojnë mbështetje për një deri në tre nxënës me vështirësi në të njëjtën ose paralele të ndryshme, varësisht nga nevojat individuale të nxënësve.

Asistentët arsimorë ofrojnë mbështetje dhe për mësimdhënësin edhe për të gjithë klasën, varësisht nga nevojat.

### **Neni 8**

Kompetencat për asistent arsimor përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë bazë të grupuara në katër fushat e mëposhtme:

1. Mbështetje e drejtpërdrejtë për nxënësit me vështirësi;
2. Bashkëpunim me prindërit/kujdestarët;
3. Bashkëpunim me mësimdhënësit dhe
4. Bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesional nga shkolla fillore dhe bashkëpunëtorët profesionalë nga shkolla fillore me qendër burimore.

### **Член 9**

Në nënfushën 1. Mbështetja e drejtpërdrejtë për nxënësit me vështirësi përfshin katër nënfusha:

1. Aktivitetet dhe detyrat shkollore.
2. Komunikimi, ndërveprimi social dhe përfshirja;
3. Lëvizja, përdorimi i ndihmave, orientimi në hapësirë dhe
4. Kujdesi për veten.

Kompetencat e asistentit arsimor në nënfushën 1.1. Mbështetja në aktivitetet dhe detyrat shkollore i referohet njohurive bazë të programeve mësimore pas së cilave punon nxënësi, njohurive dhe zbatimit të qasjeve të ndryshme në ndihmën e nxënësve për të mësuar në përputhje me nevojat e tyre, njohurive të parimeve për zhvillimin e PEI dhe programit të modifikuar dhe njohurive të rëndësishme të PEI dhe programit të modifikuar për nxënësit me vështirësi. Kompetencat gjithashtu i referohen njohurive të përdorimit të teknologjisë ndihmëse dhe zbatimit të metodave të veçanta për përdorimin e ndihmave didaktike të përdorura nga nxënësit pas trajnimit të përfunduar më parë të realizuar nga shkolla fillore me qendër burimore.

Asistenti arsimor në nënfushën 1.1. Mbështetja në aktivitetet dhe detyrat shkollore i ka detyrat e mëposhtme të punës:

- analizon, planifikon dhe organizon detyrat dhe aktivitetet e punës për të mbështetur nxënësit me vështirësi në përputhje me PEI-n ose programin e modifikuar, ndjek orarin e mësimit dhe udhëzimet nga mësuesi, si dhe udhëzimet nga bashkëpunëtori profesional - edukatori special dhe rehabilituesi i caktuar nga shkolla fillore me qendër burimore dhe ekipin gjithëpërfshirës për nxënës nga shkolla fillore.

- ndihmon nxënësit gjatë përdorimit të mjeteve didaktike (alfabeti i Brajtit, pajisje taktile dhe/ose elektronik-akustike, forma alternative të komunikimit dhe mjete e pajisje të tjera specifike), në bashkëpunim me person ekspert nga fusha përkatëse.

- gjatë orëve të mësimit, i ndihmon nxënësit me vështirësi në përdorimin e drejtpërdrejtë të mjeteve didaktike

- nëse është e nevojshme i nxjerr nxënësit nga klasa (kur ndërron klasa, i çon në palestër, dhomë për punë individuale, etj.);

- drejton vëmendjen e nxënësve të aktivitetet mësimore dhe detyrat që lidhen me ta;

- i inkurajon nxënësit të kryejnë detyra dhe udhëzime që lidhen me mësuesin;

- nëse është e nevojshme, ua lexon detyrën nxënësve;

- ua shpjegon detyrën nxënësve sipas udhëzimeve të mësuesit;

- i ndihmon nxënësit në shkrim, si dhe në kopjim nga tabela, nëse nuk kanë kohë të kopjojnë;

- i ndihmon nxënësit në kryerjen e aktiviteteve sipas udhëzimeve të mësuesit;

- monitoron punën e nxënësve dhe i drejton ata;

- i ndihmon nxënësit të angazhohen në punën e një grupi nxënësish, nëse mësuesi/ja ka planifikuar një aktivitet të tillë dhe - i ndihmon nxënësit të angazhohen në punë në grup të planifikuar më parë në bashkëpunim me mësuesin/en.

Kompetencat e asistentit arsimor në nënfushën 1.2. Komunikimi, bashkëveprimi social dhe përfshirja i referohet njohurive dhe zbatimit të metodave dhe teknikave për pranimin dhe respektimin e diversitetit, tolerancës dhe sjelljes jo të dhunshme, njohurive dhe zbatimit të llojeve të ndryshme të strategjive dhe qasjeve në komunikimin me nxënësit në mënyrë që ofron mbështetje dhe besim, zbatimit të metodave dhe teknikave të përshtatshme për udhëheqjen e punës në grup, si dhe kuptimit të proceseve të zhvillimit social dhe emocional dhe lidhjes së tyre me sjelljen e nxënësve.

Asistenti arsimor në nënfushën 1.2. Komunikimi, bashkëveprimi social dhe përfshirja ka detyrat e mëposhtme të punës:

- inkurajon nxënësit me vështirësi të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë me nxënës të tjerë, si në aktivitetet mësimore ashtu edhe jashtëmësimore;

- inkurajon nxënësit të përvetësojnë forma të pranueshme sjelljeje, qetëson nxënësit kur shfaqin ankth, shqetësim dhe frustrim;

- inkurajon nxënësit në pjesëmarrje aktive të orëve mësimore, si dhe për pjesëmarrje në aktivitete për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e nxënësve;

- orienton nxënësit mbi dëmshmërinë dhe pasojat e formave të papranueshme të sjelljes;

- u shpjegon në mënyrë shtesë nxënësve rregullat e sjelljes, punës dhe lojës dhe

- merr pjesë në zhvillimin e mbështetjes nga bashkëmoshatarët dhe mjedisit shkollor gjithëpërfshirës.

Kompetencat e asistentit arsimor në nënfushën 1.3. Ndhimja me lëvizjen, përdorimin e ndihmave, orientimin në hapësirë i referohen njohurive të zhvillimit të funksioneve psikomotorike dhe rregullave për lëvizje të sigurt në hapësirë.

Asistenti arsimor në nënfushën 1.3. Ndhimja gjatë lëvizjes, përdorimit të ndihmave, orientimit në hapësirë ka detyrat e mëposhtme të punës:

- ndihmon nxënësit nëse kanë vështirësi në ecje - mbajtje, mbështetje, udhëzim;

- kujdeset në sigurinë e nxënësve që kanë vështirësi në lëvizje në hapësirë dhe

- ndihmon nxënësit të cilët lëvizin me karrocë me rrota, veçanërisht kur hasin pengesa.

Kompetencat e asistentit arsimor në nënfushën 1.4. Ndhimja me kujdesin ndaj vetes i referohen njohurive dhe zbatimit të aftësive për ndihmë/mbështetje me të ngrënit dhe ruajtjen e higjienës personale.

Asistenti arsimor në nënfushën 1.4. Ndhimja ndaj kujdesin ndaj vetes ka detyrat e mëposhtme të punës:

- ndihmon nxënësit me vështirësi gjatë përdorimit të enëve të ngrënies dhe pirjes;

- kujdeset për respektimin e dietës ose renditjes së vakteve dhe marrjen e medikamenteve;

- ndihmon nxënësit në përmbushjen e nevojave fiziologjike (përdorimi i tualetit, etj.);

- ndihmon nxënësit gjatë ndërrimit (rroba dhe këpucë për orët e arsimit fizik dhe shëndetësor, etj.) nëse janë në shkollë, varësisht nga nevojat e nxënësve dhe situata, pas marrëveshjes paraprake me prindin/kujdestarin.

## Neni 10

Kompetencat e asistentit arsimor në nënfushën 2. Bashkëpunimi me prindërit/kujdestarët i referohen aftësive poseduese për të përcjellë në mënyrë të përshtatshme informata për zhvillimin dhe arritjet e nxënësit.

Asistenti arsimor në nënfushën 2. Bashkëpunimi me prindërit/kujdestarët ka detyrat e mëposhtme të punës:

- bashkëpunimi me prindërit/kujdestarët kryhet gjithmonë pas konsultimit paraprak me mësimdhënësit,
- bashkëpunimi me prindërit/kujdestarët është profesional, duke shkëmbyer informata të dobishme për situatat dhe ndryshimet që i kanë vërejtur tek fëmija i tyre dhe
- vepron me konfidencialitet informatat të cilat i marrin nga prindërit/kujdestarët, ndërsa janë veçanërisht të ndjeshëm dhe me natyrë konfidenciale.

## Neni 11

Kompetencat e asistentit arsimor në nënfushën 3. Bashkëpunimi me mësimdhënësit i referohen njohurive bazë të përshtatshërisë së mësimdhënies me karakteristikat e nxënësve, strategjive të të mësuarit dhe mësimdhënies, metodave të ndryshme mësimore, mjeteve, burime teknike, aktivitetet, si dhe njohurit të parimeve themelore të punës në grup, bashkëpunimit, respektit, rregullave për dhënien dhe marrjen e informatave të kthyshme.

Asistenti arsimor në fushën 3. Bashkëpunimi me mësimdhënësin ka detyrat e mëposhtme të punës:

- bashkëpunon profesionalisht me mësimdhënësit dhe prej tyre i merr dhe evidenton të dhënat për procedurat, metodat dhe aktivitetet që do t'i zbatojë për orë mësimi specifike (skanari i orës së mësimi/plani operativ ditor);
- respekton mendimin e mësimdhënësit dhe bie dakord me të për nivelin dhe llojin e ndihmës dhe mbështetjes e cila duhet t'u ofrojë nxënësve me vështirësi;
- merr dhe jep informata të pakthyeshme të mësimdhënësit dhe në bazë të së njëjtës të propozojë metoda dhe aktivitete, për të cilat konsideron të dobishme për nxënësit me vështirësi,
- bashkëpunon profesionalisht me mësimdhënësit të shkollës fillore dhe me mësimdhënësit të shkollës fillore me qendër burimore të cilët realizojnë programin e modifikuar për nxënësin dhe
- vëzhgon sjelljen e nxënësve në klasë gjatë mësimeve dhe pushimeve dhe i jep informatë kthyesme mësimdhënësit për përmirësimin klimën socio-emocionale dhe gjithëpërfshirëse në klasë dhe në shkollë.

## Neni 12

Kompetencat e asistentit arsimor në nënfushën 4. Bashkëpunimi me bashkëpunëtorët profesionalë dhe ekipin gjithëpërfshirës për nxënësin në shkollën fillore dhe në shkollën fillore me qendër burimore, i referohen njohurive dhe aftësive për realizimin e bashkëpunimit në ekip, aftësive për shprehje të qartë dhe precize me gojë dhe me shkrim, aftësive të dëgjimit aktiv, aftësive organizative, si dhe kuptimit të sfidave në komunikim dhe bashkëpunim me anëtarë të kulturave të ndryshme, me vlera dhe përvoja të ndryshme.

Asistenti arsimor në nënfushën 4 Bashkëpunimi me bashkëpunëtorët profesionalë dhe ekipin gjithëpërfshirës për nxënësin në shkollën fillore dhe në shkollën fillore me qendër burimore ka detyrat e mëposhtme të punës:

- merr pjesë në të gjitha takimet e rregullta të ekipit gjithëpërfshirës për nxënësin dhe merr pjesë rregullisht në takimet me koordinatorin e shkollës fillore me qendër burimesh.
- konsultohet me bashkëpunëtorin profesional nga shkolla fillore me qendër burimore për përgjegjësitë administrative (planifikimi i punës së vet, mbajtja e evidencës së punës, si dhe përparimi i nxënësit etj.);
- shkëmben informacion me ekip gjithëpërfshirës për nxënësin dhe shkollën fillore me qendër burimore për situatën fillestare dhe progresin e nxënësve konform planit individual arsimor dhe programit të modifikuar;
- konsultohet për përpilimin e udhëzimeve për përshtatjet të cilat janë të nevojshme nga nxënësit (hapësira, koha, qasja, burimet e punës);
- konsultohet për përzgjedhjen e metodave dhe procedurave inkurajuese dhe motivuese për punë me nxënësit dhe
- kërkon ndihmë profesionale në situata të reja/të rrezikshme;

## Neni 13

Asistenti arsimor planifikon punën e tij/saj në baza javore në bazë ditore në korrelacion me planifikimin javor të mësimdhënësit, të cilin e dorëzon deri te bashkëpunëtorët profesional në shkollën fillore me qendër burimore.

Asistenti arsimor mban evidencë për punën e tij në ditar pune dhe dorëzon raport mujor, gjysmëvjetor dhe vjetor deri te shkolla fillore me qendër burimore.

Asistenti arsimor shënon çdo ditë se çfarë dhe si ka punuar me nxënësit me vështirësi, edhe atë:

- lëndën ose fushat mësimore;

- zbatimin e formave, metodave dhe teknikave për punë
- përshkrimin e aktiviteteve gjatë punës të cilat i referohen pjesës së aktiviteteve të përbashkëta me mësimdhënësin, aktivitetet për mbështetjen e nxënësve me vështirësi dhe aktivitetet në lidhje me mbështetjen e të gjithë nxënësve (mbështetja nga bashkëmoshatarët);
- shënime/reflektime të orës dhe
- vlerësimin e orës.

Evidentime nga paragrafi 2 i këtij neni shërbejnë për:

- shkëmbimin e informatave me mësimdhënësin, prindin/kujdestarin dhe ekipin gjithëpërfshirës për nxënësin;
- monitorimin e arritjeve të nxënësve dhe
- përshtatjen e aktiviteteve, formave dhe materialeve të punës së specifikuar në PEI dhe në programin e modifikuar.

#### **Neni 14**

Asistentit arsimor është i detyruar të kryejë detyrat e punës në përputhje me programin e punës të përgatitur dhe marrëveshjen për punë, të sillet në mënyrë shembullore dhe të respektojë rendin dhe disiplinën në shkollë.

Në rast të mosrespektimit, gjegjësisht mospërbushjes së detyrimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, të vërejtur nga bashkëpunëtori profesional i shkollës fillore me qendër burimore, i njëjti është i detyruar të dorëzojë njoftim me shkrim deri te drejtori i shkollës fillore me qendër burimore.

Në bazë të fletëparaqitjes së mësimdhënësit, prind/kujdestar, anëtar i ekipit gjithëpërfshirës, koordinatori i ekipit gjithëpërfshirës për nxënës, paraqet njoftim me shkrim drejtorit të shkollës fillore komunale.

Drejtori i shkollës fillore komunale e informon me shkrim drejtorin e shkollës fillore me qendër burimore, i cili vepron në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së punës së asistentit arsimor dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

#### **Neni 15**

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vlefshmi Regullorja për përshkrimin normativ të kompetencave dhe detyrave të punës për asistentët arsimorë dhe personalë me nr. 18-13724/2 të datës 02.12.2020.

#### **Neni 16**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjelljes së tij.

№. 12-7828/2

10.06.2025

Министерка за образование и наука/

Ministre e Arsimit dhe Shkencës

проф. д-р Весна Јаневска, с.р.